

Në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, Ligjit Nr.08/L-012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit dhe Statutin e Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës për Periudhën e Përkohshme me nr. prot. 8648/24 dt.31.12.2024 dhe bazuar në Vendimin e Bordit Drejtues nr.04-BD/2025, Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës shpall:

KONKURS (PËR VEND TË LIRË PUNE)

Titulli i punës:	Drejtor Ekzekutiv i Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës
I raporton:	Bordit të Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës
Kohëzgjatja e emërimit:	4 vjet (me mundësi vazhdimi)
Niveli i pagës:	980 EURO
Orari i punës:	40 orë punë në javë
Pozita e kërkuar:	1
Afati kohor i aplikimit:	27.02.2025 – 13.03.2025
Institucioni:	Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës
Vendi i punës:	Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësit:

- Udhëheq me Administratën e Odës;
- Merr pjesë në mbledhjet e Bordit Drejtues dhe të Kuvendit të Odës;
- Pranon dhe menaxhon korrespondencën e Odës;
- Përditëson me regjistrat e Odës në përputhje me aktet përkatëse të Odës;
- Kujdeset për Vulën e Odës, të gjitha librat, dokumentet, regjistrat, korrespondencat, kontratat dhe dokumentet tjera që i përkasin Odës;
- Kujdeset për pronën e Odës dhe siguron që mjetet e grumbulluara të Odës mbliidhen dhe depozitohen në mënyrë të rregullt;
- Ofron informacione dhe raporte sipas kërkesës nga Bordi Drejtues;
- Kryen të gjitha detyrat e përditshme të menaxhimit dhe administrimit të zyrave të Odës;
- Kryen detyra të tjera të përcaktuara nga Bordi Drejtues.

Kërkesat e përgjithshme për punësim:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare të Kosovës, në përputhje me Ligjin për Gjuhët;
- Të ketë njohuri të avancuara të gjuhës angleze;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale me dashje;
- Të ketë njohuri për menaxhim strategjik të Odës (e preferueshme);

Kërkesat e përgjithshme formale:

- **Arsimimi i kërkuar:** Diplomë e arsimit të lartë - Master në Fushën: Fakulteti Juridik apo Ekonomik.
- **Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku pesë (5) vite përvojë pune menaxheriale profesionale.
- **Shkathtësitë kompjuterike:** Aftësi për të punuar në aplikacionet Word, Excel, Power Point, etj;

Kërkesa të përgjithshme (Njohuri, Aftësi, Cilësi, Kompetenca)

- Profesionalizëm;
- Aftësi organizative;
- Menaxhim i performancës;
- Gjykim dhe vendimmarrje;
- Orientimi në rezultat;
- Komunikimi dhe puna ekipore;

Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim:

- Kopje të diplomës të kërkuar me konkurs të lëshuar nga institucionet arsimor të Republikës së Kosovës. Nëse diploma është fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është në procedurë të nostrifikimit të diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë;
- Vërtetim për përvojën e punës/certifikatë e lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, e cila përcakton pozicionin e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimeve në atë pozicion. Dëshmia e përvojës jashtë institucioneve publike duhet të mbështetet së paku me njërën nga dëshmitë: leterreferencë, apo kontratë të punës, apo pasqyra e pagesave në fondin e kursimeve pensionale apo pasqyra e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- Dëshmitë e trajnimeve profesionale të ndjekura apo trajnimeve që aplikuesi i ka realizuar (e preferueshme);
- Letër motivimi;
- CV;
- Kopje e letërnjoftimit/pasaportës;
- Vërtetim nga gjykata se nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprës penale me dashje, jo më i vjetër se gjashtë (6) muaj nga data e dhënies.

Kriteret e vlerësimit:

- Kandidatët të cilët plotësojnë kushtet sipas shpalljes së konkursit do t'i nënshtrohen vlerësimit përmes intervistimit me gojë.

Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional, siç është specifikuar në Ligj. Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia e nën përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuar inkurajohen të aplikojnë për pozitat e shpallura. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk do të pranohen dhe aplikacionet e pakompletuara do të refuzohen.

Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet përmes postës elektronike në adresën e OIRK: **odaeinxhinierëve@gmail.com**